



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 8 dhe 13, të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0002354 të datës 12 janar 2021, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere dhe në kërkesë nr.prot 06-400/04-0019200/22, të datës 15.03.2022, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE

Neni 1

z.Sabri Ademi nga fshati Dobratin, Komuna e Podujevës, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore të bashkëshortes së tij znj.Lumnje Ademi dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor i jepet ndihmë financiare në shumë 300.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03-0023987/22
Podujevë, 01 prill 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Rregulloren nr. 01/2020 për sistemin e menaxhimit të performancës komunale dhe skemës së grantit për performancë komunale dhe neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, nxjerr:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR.PROT.02-020/04-0076160/20 TË DATËS 16 DHJETOR 2020

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi nr.prot.02-020/04-0076160/20, të datës 16 dhjetor 2020 për emërimin e koordinatorit dhe zyrtarëve komunal për administrimin e Sistemit për Menaxhimin e Performancës në Komunën e Podujevës, përkatësisht përbërja e plotë e anëtarëve që mbulojnë fushat referente, është si në vijim:

1. Ejup Babatinca,	koordinator	
2. Makfirete Zeka,	në fushën - Kujdesi primar shëndetësor,	anëtare
3. Liridona Rrahmani,	në fushën - Transparenca komunale,	anëtare
4. Enis Sheholli,	në fushën - Përgjegjshmëria komunale,	anëtar
5. Arianit Shaqiri,	në fushën - Shërbimet publike administrative,	anëtar
6. Arbëresha Bashota,	në fushat - Barazia në punësim / Përfaqësimi gjinor,	anëtare
7. Vedat Muçolli,	në fushën - Kulturë, rini dhe sport,	anëtar
8. Kujtim Zhitia,	në fushën - Menaxhimi i fatkeqësive,	anëtar
9. Florie Mani,	në fushën - Planifikimi hapësinor,	anëtare
10. Rizah Muçolli,	në fushat - Hapësirat publike / Menaxhimi i mbeturinave / Mbrojtja e ambientit,	anëtar
11. Ismet Kadriu,	në fushën - Infrastruktura rrugore,	anëtar
12. Afrim Mulliqi,	në fushat - Transporti publik / Parkingjet publike,	anëtar
13. Valmira Rekalii,	në fushën - Uji i pijshëm,	anëtare
14. Granit Hasani,	në fushën - Kanalizimi,	anëtar
15. Ardian Emini,	në fushën - Arsimi para-universitar,	anëtar
16. Memli Gashi,	në fushën - Zhvillimi ekonomik lokal,	anëtar

Neni 2


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti është pjesë përbërëse e vendimit nr.02-020/04-0076160/20, të datës 16 dhjetor 2020.

U dërgohet;

Të emëruarve, përmes koordinatorit

QSHQ / Arkivës

Nr.02-020/04-0024154/22
Podujevë, 01 prill 2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 11 paragrafi 6 të Ligjit për Teatrot nr. 04/L-106, nenit 12 paragrafi 1.1 të Rregullores nr.04/2015 për kushtet dhe kriteret e themelimit të teatrove kombëtare dhe të teatrove të qyteteve (MKRS), nenit 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, si dhe në pajtim me nenin 12 paragrafi 2 të Statutit të Teatrit të qytetit "Avdush Hasani"- Podujevë nr.prot.01-640-93374 të datës 28.12.2016, dhe nenin 2 paragrafi 4 të Rregullores së Punës së Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit të Podujevës "Avdush Hasani" nr.prot.01-640/01-0051835/21 të datës 28.06.2022, merr;

VENDIM PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT Nr.Prot.02-020/04-0020237/22

Neni 1

Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi nr.prot.02-020/04-0020237/22 i datës 18 mars 2022 për Emërimin e Këshillit Drejtues i Teatrit Publik të Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë, përkatësisht përbërja e anëtarëve të emëruar, dhe atë:

znj.Ryva Kajtazi, aktore, emërohet anëtare në kuadër të Këshillit Drejtues i Teatrit Publik të Qytetit "Avdush Hasani", në vend të znj.Saranda Stublla e cila ka ofruar dorëheqje për shkaqe personale.

Neni 2

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe është pjesë përbërëse e vendimit numër prot.02-020/04-0020237/22, të datës 18 mars 2022.

Me këtë njoftohen:

E emëruara

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS

Anëtarët e Këshillit (përmes DKRS)

Teatri i Qytetit

QSHQ / Arkivi

Nr.prot. 02-020/04-0024655/22
Podujevë, datë: 04/04/2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L-040 nenin 61 parag. 1.6 dhe nenin 64 parag. 3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

V E N D I M **PËR EMËRIMIN E USHTRUESIT TË DETYRËS SË DREJTORIT TË** **DREJTORISË SË PRONËS KADASTRIT DHE GJEODEZISË**

Neni 1

znj.Saranda Stublla-Uka, juriste e diplomuar, nga Podujeva, emërohet;

- Ushtruese e detyrës së drejtorit/es së Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë

Neni 2

E përmendura punët dhe detyrat e punës do t'i ushtrojë përkohësisht deri në emërimin e drejtorit/es të Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.


Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

I dërgohet:
Të emëruarës
Zyrës së personelit
Qendrës së Shërbimit për Qytetarë/Arkivi

Nr. prot. 02-20/02-0024614/22
Podujevë, datë: 04/04/2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në kërkesë të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit të datës 01.03.2022, merr:

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT Nr.Prot 02-020/04-0015044/22

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet vendimi nr. prot 02-020/04-0015044/22 i datës 01 mars 2022, Për Themelimin e Komisionit Vlerësues Për Shqyrtimin e Aplikacioneve Për Financim Publik të OJQ-Klubeve Sportive në Komunën e Podujevës, dhe atë;

z.Emin Ajvazi emërohet në vend të **z.Jeton Havolli** i cili ka dhënë dorëheqje për shkak të konfliktit të interesit.

z.Ejup Babatinca caktohet Kryesues i Komisionit Vlerësues Për Shqyrtimin e Aplikacioneve Për Financim Publik të OJQ-Klubeve Sportive në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe është pjesë përbërëse e vendimit nr.prot.02-020/04-0015044/22 të datës 01 mars 2022 .

I dërgohet:

*Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit -DKRS
Anëtarëve të Komisionit(përmes DKRS)
QSHQ/Arkivit*

Nr.prot. 02-020/04-0025165/22
Podujevë, datë 06.04.2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 12 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në kërkesë nr.02-615/03-0024347/22 të datës 04.04.2022, të Drejtorit të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE PËR PROJEKTE/PROGRAME TË ORGANIZATAVE JO-QEVERITARE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

1.Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2.Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve në Komunën e Podujevës bëhet në fushën e aktiviteteve kulturore dhe rinore për kinematografi, art, trashëgimi, turizëm, balet, festivale, panaire, ekspozita, manifestime, integrimi i grupeve rinore, aktivitete edukative (seminare, trajnime, kurse për aftësimin e të rinjve etj), nga buxheti i Komunës së Podujevës, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nën programit 85005.

Neni 2

Mjetet e financiare shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, pas vlerësimit dhe përzgjedhjes nga ana e komisionit si dhe dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:
 - 1.1. Teksti i thirrjes publike
 - 1.2. Udhëzimet për aplikantët
 - 1.3. Formularët e aplikimit sipas Rregullores MF-Nr.04/2017.

Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>.

Neni 5

1.Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2.Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranura që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3.Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 6

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 7


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit -DKRS
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-024/01-0025545/22
Podujevë, datë 07.04.2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në propozim të drejtorit të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit të datës 01.03.2022, merr:

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT Nr.Prot 02-020/04-0015046/22

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet vendimi nr. prot 02-020/04-0015046/22 i datës 01 mars 2022, Për Themelimin e Komisionit Vlerësues Për Shqyrtimin e Aplikacioneve Për Financim Publik të OJQ-ve në Fushën e Shfaqjeve Teatrorë në Komunën e Podujevës, dhe atë;

znj.Makfirete Zeka emërohet në vend të **znj.Teuta Ismajli**, e cila zëvendësohet për shkak të angazhimeve në punë.

Neni 2

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe është pjesë përbërëse e vendimit nr.prot.02-020/04-0015046/22 të datës 01 mars 2022 .

I dërgohet:

Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit -DKRS
Anëtarëve të Komisionit(përmes DKRS)
QSHQ/Arkivit

Nr.prot.02-020/04-0025542/22
Podujevë, datë 07.04.2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 16 të Statutit të Komunës nr.02-020/02-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës merr,

VENDIM

PËR NGRITJEN E KËSHILLIT ORGANIZATIV PËR SHËNIMIN E 5 MAJIT DITËS SË DËSHMORËVE DHE TË RËNËVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për shënimin e 5 Majit Ditës së Dëshmorëve dhe të Rënëve në Komunën e Podujevës, ngritët Këshilli Organizativ, në përbërje:

- | | |
|---|-----------|
| 1. Marigona Lahu , <i>Nënkryetare e Komunës</i> , | kryesuese |
| 2. Adelina Stublla , <i>Grupi i këshilltarëve të LVV</i> , | anëtare |
| 3. Naim Çunaku , <i>Grupi i këshilltarëve të LDK</i> , | anëtar |
| 4. Bashkim Syla , <i>Grupi i këshilltarëve të PDK</i> , | anëtar |
| 5. Mrika Thaçi , <i>Grupi i këshilltarëve të AAK</i> , | anëtare |
| 6. Xhemshit Gashi , <i>Përfaqësues i Shoqatave të dala nga lufta</i> , | anëtar |
| 7. Antoneta Ejupi , <i>Drejtorja e Administratës</i> , | anëtare |
| 8. Pajtim Balaj , <i>Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit</i> , | anëtar |
| 9. Mujë Monolli , <i>Kabineti i Kryetarit të Komunës</i> , | anëtar |

Neni 2

Këshilli organizon dhe bashkërendon aktivitetet për manifestimin sa më dinjitoz të shënimit të 5 Majit Ditës së Dëshmorëve dhe të Rënëve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:
Anëtarëve të Këshillit
QSHQ - Arkivit

Nr.prot. 02-020/04-0027068/22
Podujevë, datë: 14-04-2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 49 parag. 1 të Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06/L-114, nenin 10 të Rregullores (QRK) nr. 11/2020 për disiplinën dhe ankesat e zyrtarëve publik dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

V E N D I M **PËR THEMELIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMISIONIT DISIPLINOR**

Neni 1

Themelohet Komisioni disiplinor në administratën publike të Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

Halit Vërshevc , <i>udhëheqës i sektorit të shëndetësisë,</i>	kryesues
Naime Podvorica , <i>zyrtare për barazi gjinore,</i>	anëtare
Jehona Havolli , <i>zyrtare në zyrën e personelit,</i>	anëtare

Enis Sheholli, zyrtar në Zyrën ligjore, caktohet anëtar rezervë në rast të paraqitjes eventuale të konfliktit të interesit, apo në rastet e mungesës së justifikuar të ndonjë prej anëtarëve të Komisionit.

Neni 2

Funksioni dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik nr.06/L-114 dhe aktet nënligjore që i referohen fushës së veprimit të këtij ligji.

Neni 3


Komisioni themelohet në mandat tre vjeçar, përveç nëse me ndonjë akt tjetër vendoset ndryshe.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi për themelimin dhe përbërjen e komisionit disiplinor me nr.prot.02-020/04-0075419/20, datë 14 dhjetor 2020.

I dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

Nr.prot: 02-020/04-0027658/22
Podujevë, datë: 15.04.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 17 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, Ligjin për Mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera 04-L-027, nenin 44 të Ligjit nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, nenet 16 dhe 19 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, nxjerr,

VENDIM PËR NGRITJEN E SHTABIT EMERGJENT PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Neni 1

Ngritët Shtabi Emergjent për mbrojtje dhe shpëtim, për menaxhimin e krizave në nivel Komune, në këtë përbërje:

Marigona Lahu , <i>Nënkryetare e Komunës,</i>	Kryesuese
Bahri Selimi , <i>Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit,</i>	Koordinator
Antigona Çitaku - Dibrani , <i>shefe e operatives në Stacionin e Policisë në Podujevë,</i>	anëtare
Antoneta Ejupi , <i>Drejtorja e Administratës,</i>	anëtare
Leutrim Krasniqi , <i>Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbajtjes së Mjedisit,</i>	anëtar
Fatlum Osmani , <i>Drejtorja e Buxhetit dhe Financave,</i>	anëtar
Driton Veliu , <i>Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,</i>	anëtar
Ymer Llughaliu , <i>drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare - Podujevë,</i>	anëtar
Besnik Mulliqi , <i>Drejtorja e Inspeksionit,</i>	anëtar
Kujtim Zhitia , <i>zyrtar për fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi tjera në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit,</i>	anëtar
Ilaz Hoti , <i>nga Shërbimi i Zjarrfikjes,</i>	anëtar
Fatri Zhitija , <i>Zëdhënës i Komunës,</i>	anëtar

Neni 2

Shtabi Emergjent vepron në funksion të menaxhimit të situatës në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera eventuale (reshje, vërshimeve, përmbytjeve, zjarreve, tërmeteve, rrëshqitjeve të dheut e të tjera të ngjashme) në pajtim me ligjin dhe aktet tjera përkatëse të kësaj natyre si dhe koordinon ngushtë punët dhe aktivitetet me Agjencia e Menaxhimit Emergjent – AME

Neni 3

Për punët dhe angazhimet në terren, Shtabi informon Kryetarin e Komunës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi menjëherë ndërsa shfuqizohet vendimi nr.prot.02-030/04-0064175/21 i datës 03.08.2021.

U dërgohet:
Anëtarëve të Shtabit
AME-së (për njoftim)
QSHQ / Arkivit,

Nr.prot. 02-020/04-0027654/22
Podujevë, datë: 15.04.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bullhqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, nxjerr:

U R D H Ë R E S Ë

I

Kërkohet nga Drejtoria e Inspeksionit, përkatësisht Inspektorët që të veprojnë në përputhje me rregullativën ligjore në fuqi sa i përket përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësisive në fushat dhe sektorët përkatës.

II

Inspektorët komunal ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë përmes kontrollit dhe mbikëqyrjes inspektive në fushat përkatëse, në mënyrë të pavarur dhe profesionale, ndërmarrin masa, veprime dhe vendime përkatëse brenda afateve ligjore, në pajtim me ligjet dhe rregullativën ligjore në fuqi.

III

Për çdo lëshim eventual nga ana e inspektorëve komunal do të merren masa disiplinore dhe masa tjera ligjore.

IV

Për zbatimin e Urdhëresës kujdeset Drejtoria e Inspeksionit.

V

Për punët dhe detyrat sipas kësaj Urdhërese kërkohen raporte sistematike të detajuara, të cilat paraqiten në Zyrën e Kryetarit të Komunës përmes Drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit.

VI

Urdhëresa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtorisë së Inspeksionit
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-016/01-0028393/22
Podujevë, Datë: 20.04.2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 20 të Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nr. 06/L-021, nenin 6 të Udhëzimit Administrativ MF – Nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik dhe nenet 16 dhe 61 paragraf 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

VENDIM PËR THEMELIMIN E KOMITETIT TË AUDITIMIT

Neni 1

Themelohet Komiteti i Auditimit në Komunën e Podujevës, në këtë përbërje:

Lirim Thaçi, kryesues (nga jashtë institucionit të Komunës)
Sejrane Hasani, anëtare (nga jashtë institucionit të Komunës)
Haxhere Fazliu, anëtare (nëpunëse e Komunës)

Neni 2

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, sipas detyrës zyrtare caktohet në cilësinë e sekretarit të Komitetit të Auditimit.

Neni 3

Komiteti i Auditimit është organ i pavarur këshillëdhënës për Kryetarin e Komunës dhe mbështetës për Njesisë e Auditimit të brendshëm, për menaxhimin dhe kontrollin e financave publike në Komunën e Podujevës.

Neni 4

Detyrat dhe përgjegjësitë Komiteti i ushtron në pajtim Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Udhëzimin Administrativ MF – Nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi.

Neni 5

Mandati i Komitetit është tre (3) vite.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
Njesisë së Auditimit të Brendshëm
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-020/04-0028908/22
Podujevë, Datë: 21.04.2022



Kryetari i Komunës
Shpëtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 17 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, Ligjin për Mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera 04-L-027, nenin 44 të Ligjit nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, nenet 16 dhe 19 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, nxjerr,

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR. 02-020/04-0027654/22 TË DATËS 15 PRILL 2022 PËR NGRITJEN E SHTABIT EMERGJENT PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Neni 1

Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi nr.prot.02-020/04-0027654/22 i datës 15 prill 2022 për ngritjen e Shtabit Emergjent për mbrojtje dhe shpëtim, për menaxhimin e krizave në nivel Komune, përkatësisht emërohen edhe dy anëtarë në kuadër të përbërjes së Shtabit, dhe atë:

Avni Fetahu, Drejtorja e Arsimit, anëtar

Vail Shala, Kryqi i Kuq i Kosovës-Dega Podujevë, anëtar

Neni 2

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe është pjesë përbërëse e Vendimit numër prot.02-02-020/04-0027654/22, të datës 15 prill 2022.

Me këtë njoftohen:

Anëtarët e emëruar dhe Shtabi

AME-së (për njoftim)

QSHQ / Arkivi,

Nr.prot. 02-020/04-0029115/22
Podujevë, datë: 22.04.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 9.1 dhe 13.2), 3) të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0002690/22 të datës 13 janar 2022, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere merr:

VENDIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE NË GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

Neni 1

Njëqindëntëdhjetetë (193) personave në gjendje të rëndë shëndetësore dhe sociale-ekonomike u jepet ndihmë financiare në shumë të përgjithshme 17,500.00€, sipas shumave individuale të paraqitura në listat e rekomanduara nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 3

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/03-0029373/22
Podujevë, datë 26.04.2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

AUTORIZOHET z. Skender Maloku, zyrtar për vlerësimin e pronës së paluajtshme në Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, për kryerjen e punëve dhe detyrave që kanë të bëjnë me dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 2

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë si dhe Zyra e Personelit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, dhe vlen deri në marrjen e një akti tjetër administrativ.

Me këtë vendim njoftohen:

I Autorizuari

DPKGJ dhe Zyra e Personelit

QSHQ/Arkivi

Nr.prot. 02-020/02-0029377/22
Podujevë, datë: 26.04.2022



Kryetari i Komunës
Shqipërim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 17 (f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 , neneve 16 dhe 19 paragrafi 1.6 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18 dhe nenit 31.2 të Rregullores për Shërbime Publike Komunale nr. 01/155-352, Kryetari i Komunës së Podujevës, nxjerrë :

URDHËRESË PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË UJIT PËR PIJE NGA RRJETI I UJËSJELLËSIT NË SEZONIN VEROR

Neni 1

Në territorin e Komunës së Podujevës, në sezonin veror, caktohet mënyra dhe kufizimi i përdorimit të ujit për pije nga rrjeti i ujësjellësit.

Neni 2

1.Në sezonin veror, prej datës 01.05.2022 deri më 15.10.2022 ndalohej shfrytëzimi i ujit nga rrjeti i ujësjellësit, për:

- 1.1. Larjen e automjeteve, rrugëve, trotuareve dhe vendeve publike
- 1.2. Ujitjen e kopshteve, fushave me barë, pemëve apo ndonjë fushe të agrikulturës.
- 1.3. Për subjektet afariste të cilat ushtrojnë veprimtarinë e larjes së automjeteve.

Neni 3

Të gjithë konsumatorët e ujit janë përgjegjës të sigurojnë se pas pikës hyrëse, të gjitha pajisjet e ujit të jenë në funksion të plotë, duke përfshirë të gjitha rubinetet dhe pajisjet hidraulike brenda objekteve dhe pronave, si dhe pajisjeve që lidhen me sistemin kryesor të furnizimit me ujë për pije.

Neni 4

KUR "Prishtina"-Njësia në Podujevë do të sigurojë funksionalitetin maksimal të rrjetit të ujësjellësit të ujit për pije, gjithashtu është e obliguar të përgjigjet menjëherë pa asnjë vonesë, në çdo raportim të ndonjë defekti në sistemin e rrjetit të ujësjellësit dhe të bëjë riparimin në afatin sa më të shkurtër.

Neni 5

Zbatimin e Urdhëresës e bëjnë Drejtoria e Inspeksionit dhe KUR "Prishtina"- Njësia në Podujevë.

Neni 6


1. Mosrespektimi i Nenit 2 paragrafi 1.1 konsiderohet kundërvajtje dhe ndëshkohet me gjobë mandatore në shumë prej.....100,00 €.
2. Mosrespektimi i Nenit 2 paragrafi 1.2 dhe 1.3 konsiderohet kundërvajtje dhe ndëshkohet me gjobë në shumë prej.....300.00 €
3. Nëse ndëshkimet e shqiptuara mandatore nuk përmbushen në afat prej 15 ditësh, inspeksioni do të ndërmarr veprimet përkatëse ligjore.

Neni 7

Urdhëresa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-016/01-00 29790/22
Podujevë, Datë: 27/04/2022

Kryetari Komunes
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenit 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, pas publikimit të rezultateve përfundimtare nga ana e Komisionit të përzgjedhjes së OJQ-ve/ Klubeve sportive për financim publik të aktiviteteve sportive, datë 26.04.2022, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ- KLUBET SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për financim publik të OJQ-ve-Klubeve sportive për realizimin e aktiviteteve sportive, sipas Thirrjes publike dt. 02.02.2022, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme 27,800.00 €.

Neni 2

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për kushtet dhe mënyrën e realizimit të aktiviteteve sportive dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-400/03-0030225/22
Podujevë, dt. 29.04.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi